



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:016624

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734782

C.nr.356/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.D. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor me datë **24 Maj 2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.D. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që të ia paguaj, paditësit S.D. në emër të kompensimit të shujtave ditore, gjatë vitit 2022, gjithsej **170 ditë pune, në shumën prej 340.00 €**, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë me 16.01.2024, e deri në përmbushjen definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124.00 €**, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit S.D. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.M.N. nga Prizreni, në këtë Gjykatë me datën 16.01.2024 ka parashtruar padi për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në padi, paditësi ka theksuar se është e punësuar sipas kontratës së punës tek e paditura pranë SHFMU, "Lekë Dukagjini", në Prizren. Paditësi prej datës së hyrjes në fuqi të kontratës kolektive në Arsim (22.01.2021) deri më datën e shfuqizimit të kontratës kolektive nga Ministria e Arsimit më datën 21.11.2022, ka punuar 170 ditë pune. Paditësi, përmes përfaqësuesit, av. S.M.N. ka parashtruar kërkesë në DKA, për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, nga punëdhënësi i fundit vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë punë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionin arsimor. Më tutje, sipas të autorizuarit të paditësit është bërë pohimi i kërkesëpadisë nga DKA-ja përmes përgjigjes së saj, pasi që nuk e ka kundërshtuar kërkesën për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, por e ka arsyetuar mosplotësimin e obligimit me mungesën e buxhetit. Sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 thotë se: "Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionin arsimor".

Andaj, paditësi me padi kërkon që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës të kompensohet, sipas kontratës kolektive të datës 22.01.2021, për pagesën e shujtave.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar sipas tarifës së OAK-së.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se duke u bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit më datën 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit, është e pa bazuar. Po ashtu, paditësi është thirrur në dispozitat nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, pa dëshmuar se është anëtar e Sindikatës së Arsimit të Kosovës - SBASHK, po ashtu ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tij pa paraqitur prova se i ka kaluar procedurat administrative, sepse nuk ka ushtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, pra paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, por i është drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par.6.1, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjithashtu, sipas saj Qeveria e Kosovës është garantuese për implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe se Ministria e Arsimit është dashur të fillon realizimin e të drejtave që dalin nga KKAK, duke planifikuar buxhet në bashkërendim me Ministrinë e Financave, po e cila nuk ka caktuar kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive, ashtu që Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor për vitin 2023, sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara. Si dhe sipas marrëveshjes kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së

të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënëse dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Andaj bazuar në këto fakte, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU. "Lekë Dukagjini" në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura mbi ditët e prezencës në punë, për paditësin në fjalë, të datës 16.01.2024, vërtetoi faktin se paditësi, S.D. prej datës 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka gjithsej 170 ditë prezentë në punë.

Vërtetimin e lartëcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1, ngase i njëjti është dokument i lëshuara nga vet e paditura brenda fushë veprimtarisë së saj. Andaj, vërtetimi i SHFMU. "Lekë Dukagjin" nga Prizreni, si provë me të cilën vërtetohen faktet lidhur me ditët e prezencës në punë, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me numër të njoftimit 01B/490, të datës 21.11.2022.

Me nenin 35 par.7, të KKAK-së është paraparë se *"Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore"*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *"Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 134 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij."*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit-mësimdhënëse, t'ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës

Kolektive të Arsimit me numër 01/B, numër të prot. 105 e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (06.06.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 356/2024, datë 24 Maj 2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.